



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 178, datë 23.08.2021

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “SMART WATT” SH.P.K. PËR HEQJEN E LICENCËS
NR. 401, SERIA T18, PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR.72, DATË
26.03.2018**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, pika 1, gërma “dh”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 5, gërma “dh”; nenit 7, paragrafi 2, dhe nenit 9, pika 1, gërma “d”, të Rregullores për Procedurat e Heqjes së Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike dhe Gazit Natyror, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 58, datë 18.04.2017; nenit 15, të Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe pikës 5.1, gërma “dh”, të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.08.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 113/1 prot., datë 16.08.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “SMART WATT” sh.p.k., për heqjen e licencës nr. 401, Seria T18, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 02.03.2018”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “SMART WATT” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 401, Seria T18, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 26.03.2018, i ndryshuar.
- Me shkresën e protokolluar në ERE nr. 38 prot., datë 10.08.2021, shoqëria “SMART WATT” sh.p.k. ka kërkuar me vullnetin e saj heqjen e licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, për arsye se nuk e ushtron këtë aktivitet.
- Kërkesa e shoqërisë “SMART WATT” sh.p.k. për heqjen e licencës së tregtimit të energjisë elektrike, vjen në zbatim të nenit 42, pika 1, gërma “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 5, gërma “dh”, të Rregullores për Procedurat e Heqjes së Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike dhe të Gazit Natyror, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.04.2017,

si dhe pikës 5.1, gërma “dh”, të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”.

- Në nenin 7, paragrafi i dytë i *Rregullores për Procedurat e Heqjes së Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike dhe të Gazit Natyror*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.04.2017 parashikohet se: “Në rast se i licencuari është propozuar për t’iu hequr licenca për shkak të kushteve të parashikuara në pikat “dh” dhe/ose “e”, të kësaj rregulloreje, ERE do të procedojë menjëherë me zbatimin e parashikimeve të nenit 9, të kësaj rregulloreje”.
- Sa rakorduar me Drejtorinë Ekonomike dhe të Financës në ERE, subjekti ka përmbushur të gjitha detyrimet që lidhen me pagesat e rregullimit.
- Me hyrjen në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s, licenca nr. 401, Seria T18, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “SMART WATT” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 26.03.2018, bëhet e pavlefshme.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “SMART WATT” sh.p.k. për heqjen e licencës nr. 401, Seria T18, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 26.03.2018.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar bëhet e pavlefshme.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqytjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI